

## **Aneksi 5: Arsyet e Skualifikimit nga Pjesëmarrja në Thirrjen për Dorëzimin e Aplikimeve**

Aplikuesit do të përjashtohen nga pjesëmarrja në këtë thirrje për dorëzimin e aplikimeve nëse:

a) janë të falimentuar ose në proces likuidimi, nëse aktiviteti i tyre është duke u administruar nga gjykata, nëse kanë hyrë në një marrëveshje me kredituesit, nëse kanë pezulluar veprimtaritë ekonomike, nëse janë në proces gjyqësor lidhur me të tilla çështje, ose nëse janë në çdo situatë tjetër të përafërt si pasojë e një procedure të ngjashme lidhur me të cilat ka dispozita në rregulloret dhe legjislacionin kombëtar;

b) janë dënuar për një kundërvajtje lidhur me sjelljen e tyre profesionale nga një vendim gjyqësor i formës së prerë; (d.m.th. ndaj së cilit nuk mund te apelohe);

c) Autoriteti Kontraktues, pavarësisht nga mënyra, vërteton në mënyre të justifikueshme se aplikuesi është fajtor për kundërvajtje të rëndë profesionale;

d) nuk kanë përmbushur detyrimet, lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose pagesën e taksave në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin ato janë rezidentë, ose me ato të vendit të Autoritetit Kontraktues, ose me ato të vendit ku kontrata do të zbatohet;

e) janë gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme që dëmton interesat financiare të BE-së;

f) janë aktualisht subjekt i një gjobe administrative të përmendur në nenin 96(1) të Rregullores Financiare (BUDGET)/ Neni 99 i Rregullores Financiare.

Më poshtë gjenden rastet të cilave u referohet pika (e) të tilla si:

1) rastet e mashtrimit siç edhe përmenden në Nenin 1 të Konventës mbi mbrojtjen e interesave financiare të Komunitetit Evropian bazuar në Aktin e Këshillit të datës 26 Korrik 1995 (OJ C 316, 27.11.1995, fq.48.)

2) rastet e korrupsionit siç përmenden në Nenin 3 të Konventës mbi luftën kundër korrupsionit në rastet e përfshirjes së zyrtarëve të Komunitetit Evropian ose zyrtarëve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, bazuar në Aktin e Këshillit të Evropës të datës 26 Maj 1997 (OJ C 195, 25.6.1997, fq.1.)

3) rastet e pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, siç përkufizohet në Nenin 2(1) të Veprimeve të Përbashkëta 98/733/JHA të Këshillit (OJ L 351, 29.12.1998)

4) rastet e pastrimit të parave siç përkufizohet në Nenin 1 të Direktivës së Këshillit 91/308/EEC (OJ L 166, 28.6.1991, p. 77.; OJ L 344, 28.12.2001, fq.76).

Nuk mund të lidhet kontratë me aplikuesit, të cilët, gjatë procedurës së përzgjedhjes së përfituesve të grantit:

a) kanë konflikt interesi;

b) nuk paraqesin informacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues si kusht për pjesëmarrje ne procedurën e kontraktimit, ose paraqesin informacion të pavërtetë;